



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 20  
Prishtinë, 23 shtator 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Munguan: Sllobodan Petroviq dhe Bujar Bukoshi.

Nga ICO: Maria Fihl Vetting dhe Valdet Sadiku

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

*Komisioni i zhvilloi punimet me këtë*

**REND DITE**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;**
- 5. Shqyrtimi i Ligjit 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënisë;**
- 6. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryesuesi** – I njoftoi anëtarët e Komisionit për mendimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës se Projektligji për të drejtat e ish-të burgosurve politikë nuk do të sistemohet në rend dite të seancës plenare, por do t'i dërgohet propozuesit, në mënyrë që Qeveria të japë mendim si dhe të merret deklarata financiare. Propozoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

**Maria Fihl Vetting - ICO**- Tha se duhet të jeni të kujdesshëm për implikimet buxhetore për të gjitha ligjet. Ky projektligj ka implikime të mëdha financiare.

**Teuta Hadri** – Tha se Projektligji për të drejtat e ish-të burgosurve politikë, për fillim nuk ka implikime buxhetore. Ky ligj në parim duhet të kalojë pa mbështetje financiare. Më vonë, me një akt të veçantë, Qeveria duhet ta caktojë buxhetin për zbatimin e këtij ligji.

**Gjylnaze Sylja** - Tha se qëllimi kryesor është zbatimi i ligjit. Zbatimi varet nga mjetet financiare. Për të pasur qasje serioze ndaj Ligjit, në mënyrë që të bëhet përkujdesja për ish-të burgosurit politikë, është shumë me rëndësi informata se sa do të kushtojë zbatimi i tij. Domethënë Qeveria duhet të deklarohet se mund ta mbështesë zbatimin e këtij ligji.

**Nurishahe Hulaj** - Tha se deputetët e këtij kuvendi janë ata që kanë kërkuar që asnjë projektligj të mos vijë në procedurë pa deklaratën financiare. Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet ta japë mendimin për koston e këtij ligji.

**Mimoza Ahmetaj** – Parashtrroi pyetje për përfaqësuesen e ICO-së, znj Maria Fihl Vetting se çka mendoi konkretisht, kur në diskutimin e saj lidhur me këtë tha “*përveç faturës financiare*”?

**Maria Fihl Vetting ICO** - Tha se personalisht nuk e ka lexuar Projektligjin, por kolegët e saj tashmë e kanë bërë këtë dhe përveç implikimeve buxhetore, ky projektligj ka edhe disa paqartësi sa u përket përkufizimeve. Këto përkufizime duhet të jenë në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

**Sidik Idriz** – I bëri me dije anëtarët e Komisionit se janë në pikën e dytë të rendit të ditës dhe nuk mund ta shqyrtojnë këtë ligj pa vendosur nëse ky projektligj do të mbetet apo jo në rend dite. Ai propozoi që rendi i ditës të miratohet me ndryshimet e propozuara.

**Qamile Morina** – Tha se do të ishte mirë që zyra e ICO-së t'i dërgojë me shkrim vërejtjet lidhur me Projektligjin për të drejtat e ish-të burgosurve politikë, në mënyrë që ato Komisioni t'i marrë parasysh gjatë shqyrtimit.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

### *Përfundim*

- *Hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi në parim i Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

**Teuta Hadri** – Pasi takimi me ministrin e Shëndetësisë ishte bërë me propozimin e saj, raportimi që u bë nga ministri ishte i njëjtë me atë që ministri deklaroi për media, por gjendja në shëndetësi po mbetet e njëjtë. Ajo propozoi që Komisioni të dalë me konkluzione konkrete në mënyrë që të përmirësohet gjendja në shëndetësi.

**Sadik Idriz** – Lidhur me propozimin e deputetes Teuta Hadri, tha se Komisioni do të diskutojë përsëri për gjendjen në shëndetësi dhe do të dalë me konkluzione të veta.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

**Sadik Idriz** – Tha se ky projektligj ka kaluar nëpër Komision, por është kthyer për shkak të disa dilemave dhe i është kthyer Ministrisë së Punës që tashmë i ka përcjellë me shkrim rekomandimet e veta. Lidhur me shqyrtimin e këtyre rekomandimeve dhe me përgatitjen e amendamenteve për mbledhjen e radhës, propozoi të merret grupi i punës që ka qenë i ngarkuar për këtë projektligj, domethënë deputetja Flora Brovina- raportuese, Qamile Morina dhe Teuta Hadri.

### **4. Shqyrtimi i Ligjit 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënisë**

**Sadik Idriz** – Tha se ky ligj i ka kaluar procedurat në Kuvend, por nuk është nënshkruar nga PSSP-ja. Problem kryesor ka qenë ndërprerja e shtatzënisë. Vërejtjet janë shpërndarë së bashku me materialin. Shpresoi se në mbledhjet e ardhshme këto vërejtje do t'i kemi të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Propozoi të formohet një grup pune, udhëheqëse e të cilit do të jetë deputetja Teuta Hadri, ndërsa do ta ndihmonin Mimoza Ahmetaj dhe Rita Hajzeraj, që vullnetarisht u deklaruan të jenë pjesëmarrëse të këtij grupi.

**Teuta Hadri** – Tha se një ndër arsyet pse ky ligj nuk është nënshkruar nga PSSP-ja, mund të jetë ankesa që ajo e ka bërë lidhur me propozimin amendamentin, që koha për ndërprerjen e shtatzënisë të jetë dhjetë javë. Për këtë propozim, që nuk ka kaluar në Komision, ankesë ka bërë edhe dr. Ferid Agani. Ajo është e përgatitur profesionalisht pikërisht për këtë çështje dhe është e vetëdijshme se çka domethënë dhjetë javë dhe dymbëdhjetë javë afat elektiv për ndërprerjen e shtatzënisë.

**Flora Brovina** – Tha se në mandatin e kaluar ka qenë në Komisionin për Shëndetësi, kur edhe është shqyrtuar ky ligj. Komisioni ka konsultuar Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe shumë literaturë të huaj. Duke u nisur nga fakti se në Kosovë nuk ka shëndetësi primare dhe edukatë të mjaftueshme, me qëllim që vajzat dhe gratë në Kosovë të mos pësojnë të lindin për shkak se ligji e kufizon afatin në dy apo tri javë. Disa anëtarë të Komisionit e kanë përkrahur propozimin e deputetes Teuta Hadri, por shumica e ka kundërshtuar atë propozim. Përpos vërejtjes lidhur me nenin e 6-të, ku janë edhe vërejtjet e tjera për këtë ligj, që nuk është nënshkruar. Kërkoi nga kryetari i Komisionit të mos i kursejë anëtarët e Komisionit nga debati, sepse pikërisht prej tij dalin zgjidhjet më të mira.

**Gjylnaze Sylja** – Tha se nga materialet që iu kanë dorëzuar shihet se edhe Task Forca e UNMIK-ut, që është agjenci brenda UNMIK-ut, ka bërë kërkesë në këtë komision, që afati për abort të mos jetë dhjetë javë, por të jetë dymbëdhjetë javë. Propozoi që grupi i punës t'i marrë për bazë këto propozime, por mbi të gjitha ta marrë për bazë interesin e grave të Kosovës. Propozoi të konsultohet edhe Shoqata e Gjinekologëve, në mënyrë që të kemi informata për gjendjen në terren dhe ta kemi mendimin e tyre profesional.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se shëndeti riprodhues në Kosovë është shumë i rëndësishëm. Ky ligj është dashur të jetë tani në zbatim. Në bazë të të dhënave, në Kosovë rreth 45 % e nënave nuk e dinë kur e kanë pasur ditën e parë të menstruacionit të fundit. Ky është një problem shumë i madh. Konsideron se afati për ndërprerjen e shtatzënisë duhet të jetë dymbëdhjetë javë, me qëllim të informimit të nënave.

**Armend Zemaj** – Tha se grupi i punës, që do të merret me shqyrtimin e ligjit, është profesional të bëjë propozime konkrete që pastaj Komisioni të merret me shqyrtimin e tyre. Secili nga anëtarët e Komisionit mund të bëjë propozime, për të cilat pastaj vendos Komisioni.

**Sadik Idriz** – Propozoi të organizohet një takim me Shoqatën e Gjinekologëve, me OBSH-në dhe me UNFPA-në.

## 5. Të ndryshme

**Sadik idriz** – Tha se deputeti Armend Zemaj dhe NDI-ja kanë propozuar organizimin e një dëgjimi publik në rajonin e Gjilanit ose të Pejës, me temën gjendja në shëndetësi. Ishte i mendimit të miratohet ky propozim dhe këtij grupi t'i bashkohet edhe një deputet tjetër nga ky komision. Propozoi që ky deputet të jetë znj. Nurishahe Hulaj, që vullnetarisht u deklarua se dëshiron të marrë pjesë në organizimin e këtij dëgjimi publik.

**Shefki Kastrati** – **NDI** – Propozoi që në të njëjtën ditë, kur mbahet dëgjimi publik, të vizitohet edhe Spitali Rajonal i Gjilanit.

**Gjylnaze Syla** – Propozoi të hartohet një kornizë e pyetjeve për dëgjimin publik, në mënyrë që Komisioni ta arrijë qëllimin e këtij dëgjimi: mbledhja e informatave të mjaftueshme.

**Armend Zemaj** – Tha se e ka paraparë të ketë një kornizë të pyetjeve për dëgjim publik, në mënyrë që Komisioni të ketë informata të mjaftueshme.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

### *Përfundim*

- *Të mbahet një dëgjim publik për gjendjen në shëndetësi në rajonin e Gjilanit. Dëgjimi do të mbahet më 7 ose 8 tetor 2008.*
- *Të vizitohet Spitali Rajonal i Gjilanit. Vizita të bëhet po atë ditë kur mbahet dëgjimi publik.*

**Sadik Idriz** – I njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën që ka marrë nga NP “Barnatoret e Prishtinës”. Ai tha se përmbajtja e kësaj kërkesë nuk korrespondon me fushveprimtarinë e Komisionit për Shëndetësi dhe ishte i mendimit se Komisioni me një shkresë t’ia kalojë këtë kërkesë për shqyrtim Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

### E përgatiti

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

*Sadik Idriz*